

1. Nëse $p(B)=1-p(A)$, atëherë:
 - A) A dhe B janë ngjarje të papajtueshme
 - B) A dhe B janë ngjarje të kundërta
 - C) A ngjarje e sigurtë, B jo e pamundur
 - D) B ngjarje e sigurtë, A jo e pamundur
2. Hidhet një zar kubik. Probabiliteti që të bjerë numër tek është:
 - A) 3
 - B) 1
 - C) 1/2
 - D) 0
3. Një kuti ka dy sfera të kuqe, 3 të bardha dhe 5 të verdha. Nëse nga kutia nxjerrim rastësisht një sferë, probabiliteti që të jetë e kuqe ose e verdhë është:
 - A) 3/10
 - B) 4/10
 - C) 2/3
 - D) 7/10
4. Hedhim dy herë një monedhë simetrike. Sa është probabiliteti i ngjarjes "Monedha bie nga e njejtja anë"
 - A) 1/4
 - B) 1/3
 - C) 1/2
 - D) 2/3
5. Në kuti janë 10 sfera të numruara 1,2,3.....10. Nxirret një sferë pa e parë. Sa është probabiliteti i ngjarjes "Bie sfera me numër çift dhe më e vogël se 8"
 - A) 3/10
 - B) 4/10
 - C) 5/10
 - D) 8/10
6. Një familje ka dy fëmijë. Sa është probabiliteti që të dy fëmijët të jenë vajza.
 - A) 1/4
 - B) 1/3
 - C) 1/2
 - D) 2/3
7. Një kub ka tri faqe blu, dy të kuqe dhe një faqe të verdhë. Kubi rrokulliset. Sa është probabiliteti që të bjerë faqe blu.
 - A) 1/6
 - B) 2/6
 - C) 3/6
 - D) 4/6
8. Hidhet një zar kubik. Sa është probabiliteti i ngjarjes "Bie numër i thjeshtë ose çift"
 - A) 1
 - B) 1/3
 - C) 1/6
 - D) 5/6
9. Hidhen njëkohësisht dy monedha. Sa është probabiliteti i ngjarjes "Bie një herë lek dhe një herë stemë"
 - A) 1/2
 - B) 1/3
 - C) 1/4
 - D) 1
10. Hidhen njëkohësisht tri monedha. Sa është probabiliteti i ngjarje "Bie dy herë lek"
 - A) 3/8
 - B) 2/9
 - C) 1/8
 - D) 1/4
11. Pesë persona ulen në mënyrë të rastësishme në një tryezë të rrumbullakët. Të gjendet probabiliteti që dy persona të caktuar të mos jenë ulur afër njëri-tjetrit.
12. Tre numra janë zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga bashkësia me 5 numra pozitivë dhe 7 numra negativë. Sa është probabiliteti që prodhimi i tyre të jetë numër pozitiv.
13. Hidhet një zar dhe një monedhë. Gjeni probabilitetin e ngjarjeve:
 - a) Zari bie numër çift
 - b) Monedha bie S
 - c) Zari bie çift ose monedha bie S
 - d) Zari bie çift dhe monedha bie S
14. Hidhen dy zare të dallueshëm. Sa është probabiliteti i ngjarjes:
 - a) Zari i parë bie çift
 - b) Shuma e pikëve të rëna në dy zaret është më e madhe se 4
 - c) Zari i parë çift dhe shuma e pikëve të rëna më e madhe se 4
 - d) Zari i parë çift ose shuma e pikëve të rëna më e madhe se 4
15. Në bashkësinë e numrave dyshifrorë, zgjedhim rastësisht një numër. Sa është probabiliteti që numri të jetë
 - a) Çift
 - b) Shumfish i 5
16. Nga 5 vajza dhe 9 djem zgjidhet një grup prej 5 personash. Gjeni probabilitetin e ngjarjes:
 - a) Grupi ka dy vajza dhe 3 djem
 - b) Grupi ka të paktën 4 djem
17. Në një kuti ka 24 sfera, prej të cilave 8 janë të shënuara. Nxirren rastësisht 5 sfera. Sa është probabiliteti që 2 të jenë të shënuara.